



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

UDHEZIM PLOTESUES

Nr. Date . 2010

“PER PERGATITJEN E BUXHETIT TE SHTETIT DHE FONDET SPECIALE”

Ne perputhje me nenin 27 te Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, Ministri i Financave,

U D H E Z O N:

Hyrje

Kerkesat per Programin Buxhetor Afatmesem 2011-2013 duhet te pergatiten ne zbatim te Udhezimit nr.7 date 22.02.2010 “Per Pergatitjen e Buxhetit te Shtetit dhe Fondet Speciale” dhe te ketij Udhezimi Plotesues.

A. Tavanet per Pergatitjen e Buxhetit

- Tavanet Perfundimtare te Shpenzimeve te Programit Buxhetor Afatmesem 2011-2013 do t’ju dergohen zyrtarisht nga Ministria e Financave, ne nje moment te dyte.

B. Afatet per Pergatitjen e Buxhetit

- Bazuar ne nenin 27 te Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, pergatitja e kerkesave buxhetore per Fazen II te PBA 2011-2013 fillon me date 10.07.2010 dhe perfundon **ne daten 31 Gusht 2010**.
- Ndeshkimet e parashikuara ne nenin 71 te Ligjit nr.9936 i dates 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise” zbatohen per nepunesit autorizues ne cdo rast te mosrespektimit te **Udhezimit nr.7 date 22.02.2010** “Per pergatitjen e buxhetit te shtetit dhe fondet speciale” dhe te ketij Udhezimi Plotesues.

C. Procedurat per Pergatitjen e Kerkesave Buxhetore

- Procedurat per hartimin e kerkesave buxhetore jane te detajuara ne Udhezimin e sipercituar dhe anekset perkatese, dhe do te realizohen nepermjet programit software per ato njesi te qeverisjes qendrore dhe fondet speciale te tyre te cilat kane akses ne govnet.
- Ndersa, njesite e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale qe nuk kane akses ne softin e PBA, ndonese ndjekin te njejtat procedura, dorezojne kerkesat e tyre buxhetore, sikurse ne Fazen I, sipas formateve standarte ne Excel qe jane pjese e Udhezimit nr.7 date 22.02.2010 “Per Pergatitjen e Buxhetit te Shtetit dhe fondet speciale”.

- Paraqitja e kërkesave per shpenzime kapitale realizohet ne baze te procedurave te Menaxhimit te Investimeve Publike, sipas udhezimit te sipercituar. Nje vemendje e vecante duhet t'i kushtohet planifikimit te shpenzimeve per Kosto Lokale dhe TVSH-Detyrime Doganore per projektet e huaja, sidomos per fondet nen programin IPA.
- **Ne ndryshim nga Faza e I e PBA 2011-2013**, gjate Fazes II nuk do te pergatiten kërkesa shtese. Pra, procedurat per hartimin e kërkesave shtese nuk jane te aplikueshme ne Fazen e II te pergatitjes se PBA-se.
- **Ne ndryshim nga Faza e I e PBA 2011-2013**, gjate Fazes II do te plotesohen **brenda tavaneve te miratuara** edhe pasqyrat e Aneksit 7/A te Udhezimit te sipercituar. Ne kuader te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi, te miratuara nga Keshilli i Ministrave mbi disiplinimin e shpenzimeve buxhetore, ju informojme se te dhenat e detajuara ne nivel programi deri ne nivel **nen-artikulli** te paraqitura ne pasqyrat e Aneksit 7/A, do te jene pjese e ligjit vjetor te buxhetit.

D. Monitorimi dhe Vleresimi i Programit Buxhetor Afatmesem

- Sic percaktohet edhe ne Udhezimin e Ministrit te Financave Nr.1 date 21.01.2010 “Per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2010”, si dhe ne udhezimin mbi procedurat e monitorimit derguar te gjitha Ministrive/Institucioneve buxhetore me shkresen e Ministrise se Financave Nr.9709 date 22.09.2008 (i disponueshem ne faqen e internetit te Ministrise se Financave <http://www.minfin.gov.al/downloads/udhezimi%20i%20monitorimit%20shqip%20doc%202.pdf>), Ministrite e linjes/Institucionet buxhetore duhet te paraqesin ne Drejtorine e Pergjithshme te Buxhetit, brenda dates 28 te muajit pasardhes te cdo tremujori, informacion te detajuar mbi performancen e produkteve te buxhetit 2010 sipas tre-mujoreve, si dhe brenda dates 30.01.2011 performancen e produkteve te buxhetit 2010, duke identifikuar:
 - ✓ *Realizimin ne vlere dhe ne terma sasore te produkteve te parashikuara;*
 - ✓ *Shmangiet nga parashikimet e periudhave si dhe shkaqet kryesore te ketyre mosrealizimeve;*
 - ✓ *Propozim te masave per permiresimin e situates brenda vitit buxhetor;*
- Per vitin 2010, ashtu sic eshte theksuar edhe ne udhezimin e zbatimit te buxhetit 2010, Ministrite e linjes/Institucionet buxhetore duhet te perdorin software-in e PBA-se dhe formatet e raportimit te ketij software (dritarja “Raportet e monitorimit”). Per institucionet buxhetore, qe nuk mund te perdorin software-in e PBA-se, raportet e monitorimit do te behen sipas formateve excel (pjese e udhezimit te zbatimit te buxhetit). Ministrite e linjes/Institucionet buxhetore qe nuk kane hedhur te dhena ne software per vitin 2010, te dhenat e hedhura ne soft per tremujorin e trete te 2010 duhet te jene kumulative per tre periudhat e para te vitit, dhe duhet te shoqerohen me nje informacion me shkrim ne lidhje me rezultatet e periudhes se trete te vitit, me qellim analizimin e performances se periudhes ne fjale.
- Duke filluar nga tremujori i pare 2010, nepunesit autorizues te njesive te qeverisjes qendrore duhet te sigurojne botimin e raporteve tremujore te monitorimit (derguar Ministrise se Financave) edhe ne faqen zyrtare te internetit te Ministrise se linjes/Institucionit buxhetor perkates, duke i depozituar njekohesisht edhe ne Ministrine e Financave sipas link-ut te website ne te cilin eshte raportuar ky raport.
- Nepunesi i pare autorizues publikon ne faqen zyrtare te Ministrise se Financave, link-un me faqet zyrtare te cdo Ministrie linje/Institucioni buxhetor ku jane publikuar keto raporte monitorimi.
- Ministrite e linjes/Institucionet buxhetore duhet te shfrytezojne maksimalisht, kapacitetet e asistences teknike nderkombetare te ofruar per procesin e monitorimit gjate fazes se trete, me qellim qe te rrisin cilesine e monitorimit te performances se produkteve, si dhe te pergjigjen me mire ne kohe e cilësi kërkesave qe ky proces parashtron.

E. Dorezimi i Raporteve te Kerkesave per Shpenzime te PBA 2010-2013

- Ritheksojme se raportet qe duhen te dorezohen deri me date 31 Gusht 2010 nga institucionet qendrore dhe fondet speciale te tyre jane te pasqyruara ne Seksionin (H) te Udhezimit te sipercituar, duke perjashtuar raportet e kerkesave shtese te cilat nuk jane pjese e Fazes II te PBA 2011-2013.
- Gjithashtu, krahas raporteve te siperpermendura, te gjitha njesite e qeverisjes qendrore dhe fondet speciale te tyre duhet te paraqesin edhe pasqyrat e **Aneksit 7/A** te Udhezimit te sipercituar. Keto pasqyra dorezohen zyrtarisht dhe ne forme elektronike. Forma elektronike paraqitet ne adresen email: budget.programming@minfin.gov.al.

F. Seancat Degjimore me Njesite e Qeverisje Qendrore dhe Fondet Speciale te tyre

- Perkatesisht, gjate periudhes **13-24 Shtator 2010** (sipas Aneksit 8 te Udhezimit nr.7 date 22.02.2010 “Per Pergatitjen e Buxhetit te Shtetit dhe fondet speciale”), Ministria e Financave, ne bashkepunim me DEBASKON prane Keshillit te Ministrave dhe Ministrine e Integritimit, zhvillon seanca degjimore me secilen njesi te qeverisjes qendrore, gjate se cilave diskutohen kerkesat e rishikuara te PBA 2011-2013 dhe jepen rekomandimet perkatese.

G. Mbeshtetja Keshillimore per Ministrite e Linjes dhe Institucionet Qendrore

- Ministria e Financave, ne kuader te mbeshtetjes keshillimore per pergatitjen e PBA 2011-2013, ve ne dispozicion te njesive te qeverisjes qendrore dhe fondeve speciale te tyre adresen email: budget.programming@minfin.gov.al dhe numrat e telefonit 228 11 23 dhe 228 11 32.

RIDVAN BODE

MINISTER

Konceptoi: Xhoana AGOLLI
Konfirmoi: Gentian OPRE
Gelardina PRODANI
Mimoza DHEMBI